



Бр./Nr. 04-403/1
14.05. 2023 год.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alinea 2 i të Ligjit për nëpunësit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14 и 27/16, 35/2018, 198/18 и 143/19) dhe neni 22 paragrafi 1 alinea 1 dhe neni 23 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, ... 27/16, 120/18 dhe 110/19), Agjencia e Rezervave të Detyrueshme të Naftës shpall

KONKURS PUBLIK nr.01/2023

për punësim të 1 (një) nëpunësi me kohë të caktuar në Agjencinë e Rezervave të Detyrueshme të Naftës për shkak të vëllimit përkohësisht të shtuar të punës, deri në fund të vitit rrjedhës fiskal (2023)

Agjencia e Rezervave të Detyrueshme të Naftës ka nevojë për punësim të 1 (një) nëpunësi me kohë të caktuar deri më 31.12.2023 për këtë vend pune përkatës:

1. Bashkëpunëtor/e i/e kontabilitetit material – njësia e llogarisë dhe pagesave dhe kontabilitetit material, në sektorin për çështje finansiare, (1) realizues;

a) Kushte të veçanta:

- niveli i kualifikimeve: të ketë mbaruar VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas EKTS ose të ketë mbaruar shkallën e VII/1, Shkenca ekonomike.

- së paku një vjet përvojë pune në profesion.

b) Kompetenca të veçanta për vendin e punës:

- njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë,

-njohje aktive të njërës nga tri gjuhët që përdoren më shpesh në Bashkimin Evropian (gjuhë angleze, frenge, gjermane);

c) Orari ditor i punës: (07:30/08:30-15:30/16:30), 8 orë pune në ditë - nga e hëna deri të premten.

ç) Shuma e neto pagës bazë për vendin e punës është 23.880,00 denarë

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës.

Агенција за задолжителни
нафтени резерви

ул. Орце Николов, бр 71
1000 Скопје, п.факс 375
Република Северна Македонија
Тел. +389 2 3225 228
+389 2 3225 153
Факс. +389 2 3225 165
Сајт: www.dcor.gov.mk
e-mail: info@dcor.gov.mk

Agjencia e Rezervave të
Detyrueshme të Naftës
rr.Orce Nikollov – 71
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel. +389 2 3225 228
+389 2 3225 153
Fax. +389 2 3225 165
www.dcor.gov.mk
e-mail: info@dcor.gov.mk



Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i përmbushin kushtet për të konkurruar.

Kandidatët janë të detyruar që sëbashku me **Fletëparaqitjen** që është shpallur në internet faqen e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës www.dcor.gov.mk të dorëzojnë edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të nevojshme në formë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter, dhe atë:

- Dëshmi se është shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë e ndalesës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (e lëshuar nga Gjyqi apo Regjistri Qendror);
- Dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore;
- Certifikatë ose diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
- Dëshmi për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës gjuhë e cila më së shpeshti përdoret në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane);
- Biografi të shkurtër (me adresë dhe kontakt telefon të patjetërsueshëm);
- Letër motivuese.

Me kandidatët e zgjedhur do të kontraktohet marrëveshje për punësim me afat të caktuar deri më datën 31.12.2023.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është 3 (tre) ditë pune nga dita e shpalljes së Konkursit. Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohet në arkivin e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës ose me anë të postës në adresën në vijim:

Agjencia e Rezervave të Detyrueshme të Naftës
Rr. "Orce Nikollov" nr.71, 1000 Shkup,
Arkivi i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës
(me shenjë "për konkursin për punësim").
Numri kontaktues: 02 3225 228

Fletëparaqitjet (lutjet) të pakompletuara dhe me vonesë nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit (nuk do të merren parasysh).

Agjencia e Rezervave të Detyrueshme të Naftës

u.d. Drejtor
Ulusi Bekiri

